Procesverbal 01/2018

I mbajtur me datën **31.01.2018** në mbledhjen e I-rë të rregullt të KK-së, e udhëhequr nga Kryesuesja e KK-së, znj.Kristina Gashi Bytyçi, të pranishëm ishin, Kryetari Komunës, z. Agim Aliu, Nënkryetari i Komunës, z. Naim Ferati, Drejtorët e drejtorive të komunës, përfaqësuesit e OJQ, AVONET dhe INPO, Përfaqësuesi i OSBE dhe mediat.
Mbledhja filloi në ora10 h.

Kryesuesja e KK-së – znj. Kristina Gashi Bytyçi – Përshëndetje kryetar i Komunës z. Agim Ali nënkryetari i komunës z. Naim Fereti përshëndetje drejtor të drejtorive të komunës, shumë të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Ferizajt përfaqësuesve të shoqërisë civile përfaqësues të mediave, Përfaqësuesi i OSBE, MAPL dhe musafit të tjerë, shumë të nderuar qytetar të Komunës së Ferizajt që po na përcjellni përmes valëve të radiotelevizionit Tema,
Zonja dhe zotërinj mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të kuvendit të komunës për vitin 2018 duke ju dëshiruar të gjithëve shëndet suksese në punë dhe fillim të mbar të mandatit të ri në KK duke ju njoftuar se para juve i keni tri dokumente me rëndësishme, si Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Ministrisë së Administratës Publike, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit që do të na përcjellin në vazhdimësi për punë në kuvend.

Të nderuar anëtar të kuvendit më lejoni që ta prezantoj rendin e punës duke menduar se në afatin e lejuar ligjor i keni marr materialet për këtë seancë.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së.
2. Betimi i dy anëtarëve të ri të KK- së.
3. Miratimi i rendit të ditës.
4. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
5. Njoftim për emërimin e Drejtorëve të Drejtorive të Komunës.
6. Propozim – Vendim për themelimin e Komiteteve të përhershme:
   a) Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe
   b) Komiteti për komunitete.
7. Propozim – Vendim për caktimin e dy kandidatëve nga KK-ja për anëtar të komisionit për ndarjen e bursave për student për vitin akademik 2017/2018.
8. Propozim për miratimin e vendimeve për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve në ndërmarrjet publike:

a) KRM "Pastërtia".

b) KRUK "Bifurkacion",

c) N.P "Stacioni i autobusëve",

d) N.P "Ambienti".

9. Propozim – Vendim për fillimin e procedurave për rishikim të PZHK-së.
10. Caktimi i orarit të mbledhjeve të KK-së për vitin 2018.
11. Propozim – Vendim për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit nga radhët e partive politike të përfaqësuara në Kuvend, për hartimin e Planit të kuvendit të KK-së.
12. Pyetjet dhe kërkesat e anëtarëve të KK-së dhe
13. Të ndryshme.

Pika 1

Kryesuesja e KK-së -Kristina Gashi Bytyçi - Konstatoj se ja prezent 40 anëtarë të asamblesë komunale.

Pika 2

Kryesuesja e KK-së -Kristina Gashi Bytyçi – Ftoi dy anëtarë të ri të kuvendit të komunës për dhënien e betimit: znj. Zymrije Haxhimusa nga radha e AAK dhe Xhafer Berishën nga radha e NISMA-së.
Anëtarët e rinj të kuvendit të komunës; znj. Zymrije Haxhimusa nga radha e AAK dhe Xhafer Berishën nga radhët e NISMA-së u betuan para anëtarëve të kuvendit.

Kryesuesja e KK-së -Kristina Gashi Bytyçi e hapë diskutimin për rendin e ditës:

z. Muharrem Svarqa- I nderuari Kryetari i Komunës, shumë e respektuar kryesuese e kuvendit të nderuar asamblistë, anëtarë të qeverisë komunale, përfaqësues të organizatave jo qeveritare përfaqësues të OSBE-së shoqërisë civile dhe përfaqësues të mediave, unë dola të diskutoj për rendin e ditës por para se të filloj dëshiroj që në emër të LDK-së të uroj për këtë mandat anëtarët e legjislativit dhe ekzekutivit ne veçanti drejtorë që do të jeni bartës të projekteve të qeverisë që do të aprovohen këtu në komunë.
Ndoshta për politikën e Komunës së Ferizajt ka qenë pazakontë që Kryetari i komunës pas verdiktit të popullit por pa pas asnjë ndjenjë të nënçmimit ta pranoj rolin e ri, asamblist, anëtarë të kuvendit sikurse unë këtë rast. Por qëllimi kryesor është që ne të punojmë për harmonizimin e qëndrimeve të përbashkëta dhe për luftimin e shkallës së polarizimit të mëtejmë për fat të keq, mirëpo kjo nuk është arsye që gjithmonë të pajtohemi, mirëpo mund të them se në këtë rast ekzistojnë pika të rendit të ditës të cilat nuk janë në harmoni as me ligjet pozitive në fuqi të Republikës së Kosovës dhe as me udhëzimet administrative të cilat specifikohen në mënyrën e zbatimit të atyre ligjeve.

Kryetari i komunës thirret në po të njëjtat ligje dhe neve nuk na lejohet të diskutomë për marrjen e vendimeve në harmoni me ligjet, ose thirrja parciale në pjesë të ligjeve që fillojnë nga preambula e propozimit e deri në arsyetim.
Prandaj unë dëshiroj me që është propozuar edhe rishikimi i PZHK-së që të shpreh mungesën e indiferentizmit tim që të kalohet kjo pik pa u sqaruar sepse edhe në mandatin e kaluar ka qen një nga pikat më të nxehta për diskutim deri në aprovimin e tij. Për shkak se këtu ka edhe asambleist që kanë qen pjesë e diskutimit pro dhe kundër por megjithatë është aprovuar si njëri nga dokumentet më të rëndësishme pas statutit që është akt themeltar.
E drejta që më jep shfrytëzimin e kësaj foltore natyrisht me jep mundësinë edhe leximit, interpretimit dhe të demontimit të kësaj pike. Në këtë propozim në preambulë shkruan në bazë të ligjit për Planifikimin e Hapësinor nr. o4-174, ligji në fuqi i planifikimit hapësinor thirret në nenin 11 dhe propozohet Rishikimi i PZHK. Neni 11 i rregullon vetëm përgjegjësit e komunës me dokumentet e planifikimit hapësinor dhe kompetencat e komunës. Apsulutishkishtë nuk gjendet fjala rishikim. Thirreni edhe në nenin 12 të Udhëzimit Administrativ 11/2015 i cili thotë që ky ligj në kapitullin e tret të tij në nenin 12 tregon zbatimin dhe monitorimin. Ju lutem, unë po e arsyetoj pse nuk duhet me qen në rend dite.
Të gjithë e dimë se shteti është në kontinuitet nuk mund kush të vjen me ndërpre gjithçka me ndërtuar diçka të re se duhet të ruajmë kontinuitetin siç e kemi rastin e ruajtjes së kontinuitetin me dy zyrtarë të lartë si z. Naim Faretin Nënkryetar dhe Faruk Hyseni Drejtor të drejtorisë për Administratë të Përgjithshme. Kontinuiteti duhet të ruhet edhe në projekte dhe zbatim të dokumenteve.

z. Lulzim Aliu – Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis - Përshëndeti të pranishmit, Kryetar, Kryesues, koleg të nderuar, anëtar të nderuar, posaçërisht për ju që jeni të ri, në fakt kryesuese nëse ka edhe të tjerë që duan me diskutuar mundem me dhënë përgjigje të përgjithshme përfundimtare. Por sa për fillim unë desha të njoftoi ish kryetarin z. Svarqa që nuk është çështje e polarizimit, nuk është çështje të inateve, nuk është çështje e hakmarrjes ose zhvlerësimit të një dokumenti të rëndësishëm për planifikimin hapësinor mund të diskutojmë, a mund të quhet rishqyrtim apo ndonjë shprehje adekuate qe mund të parashihet saktë me ligj, por domosdoshmëri e trajtimi të këtij dokumenti është e domosdoshme që realisht i arsyetoi pak më vonë.

Pika 3

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi - Kërkoi nga të pranishmit aprovimin e procesverbalit se a ka dikush vërejtje në procesverbal.

z.Dritëro Hyseni – Përshëndetje për të gjithë, Kryetar, Kryesuese, anëtarë të kuvendit, unë mendoi që në procesverbalin e mbledhjes së kaluar ka munguar fjalia që kanë qenë 7 vota kundër.

Kryesuesja e kuvendit Kristina Gashi Bytyçi - Këtë vërejtje sigurisht se do ta merr parasysh procesmbajtësi dhe do të përmirësoi për mbledhjen e radhës dhe njëkohësisht konstatoi praninë 40 anëtarëve prezent, të cilët ishin pro, miratimit të procesverbalit me një vërejtje.

Pika 4

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi - Njoftimi për emërimin e Drejtorëve të drejtorive të Komunës.

Kryetari i Komunës z. Agim Aliu – E nderuara Kryesuese e Komunës së Ferizajt znj. Kristina Gashi Bytyçi, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt, të nderuar përfaqësues të OSBE-së, të shoqërisë civile, të mediave, të nderuar qytetar të Komunës së Ferizajt, mbi të gjitha më lejoni që posa të betuarve t'u urojë për marrjen e mandatit si anëtare e kuvendit, pra më lejoni edhe një herë që të gjithë ju pasi që është seanca e parë e kuvendit të komunës t'iu dëshiroi mbarsi në punët, angazhimet, sfidat që na presin në këtë 4 vjeçar. Unë tani jam zotuar para jush dhe para qytetarëve të Komunës të Ferizajt që të jem bashkëvepruese dhe Kuvendi dhe Komuna e Ferizajt pa dyshim do të jetë shembull i një qyteti, një komune dhe se do të punoi për interesin e qytetarëve dhe për të mirën e tyre pavarësisht një nisje të tillë që u çfar në Kuvendin e komunës, nuk është e imja të interpretoi, por unë po besoi se në Komunën e Ferizajt do të kthehet rendi, ligji, disiplina financiare, po mbi të gjitha do të kthehet ajo që është në interes të gjithë qytetarëve dhe unë tash ma e kam këtë mandat për të zbatuar atë që ishte vullnet i qytetarëve të Komunës së Ferizajt.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të komunës, e nderuara Kryesuese e Kuvendit të Komunës komfor obligimit ligjorë, statutar, ndihem i privilegjuar të ju njoftoi. Sot me përbërjen e kabinetit tim, drejtorëve të rinjë bashkë me të cilët në mandatin 4 vjeçar synojmë një qeverisje efektive, funksionale dhe cilësore në drejtim të faktorizimit dhe zhvillimit të më tutjeshëm të Komunës së Ferizajt.

Si rezultat i pikave të bashkëpunimit, Drejtorët e rinjë janë personalitete të dëshmuara, të zgjedhur pas konsultimeve cilësor me të gjithë partnerët e mi.

Në periudhën 4 vjeçare 2017-2021 kam vendosur që bashkëpunëtorët e mi të parë të janë:

1. z. **Naim Ferati nënkryetar i Komunës;**
2. **znj. Sebahate Ajeti Sadiku - Drejtore e Drejtorisë së Financave;**
3. **z. Faruk Hyseni – Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme;**
4. **z. Bashkim Hysen - Drejtor i Drejtorisë për Arsim;**
5. **z. Besnik Berisha - Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;**
6. **z. Lulzim Aliu - Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis;**
7. **z. Sabri Murseli Drejtor i Drejtorisë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër;**
8. **znj. Xhemile Murati Shabani – Drejtore e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport;**
9. **z. Burim Bajrami - Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari;**
10. **z. Arben Halili - Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë;**
11. **z. Zekri Bytyqi - Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm;**
12. **z. Arben Bytyqi - Drejtor i Drejtorisë për Infrastrukturë.**

Në përzgjedhjen e drejtorëve, kam pasur parasysh gjetjen e kualiteteve, të cilat njëkohësisht do të përputheshin edhe me pritjet e qytetarëve të Komunës sonë.

Profesionizmi, energjia e re, kreativiteti si dhe motivimi për sendërtimin e politikave të deklaruara zhvillimore për komunën tonë, kanë qenë kriteret e mia për emërimin e bashkëpunëtorëve të mi të parë.

Jam i bindur që kjo përbërje e kabinetit tim, më shumë se për kah origjina politike e të të emëruarve, do të mbahet mend për profilin, qytetar të angazhimit, profil ky që do të jetë gjithnjë i gatshëm të mbështesë dallimet eventuale, në shërbim të identifikimit të ideve që na unifikojnë, drejt krijimit dhe ekzekutimit të politikave që do ta përmirësojnë cilësinë e jetës së bashkëqytetarëve tanë, në të gjitha segmentet

Përveç moshës së re të shumicës së drejtorëve e drejtoreve të reja, energjisë e kreativiteti ambicioz të tyre, jam i bindur që inkurajon shumë edhe statusi profesionist i tyre. Që të gjithë janë personalitetet të dëshmuara dhe me rezultate të shquara në fushën e menagjimit, me theks të veçantë, në fushat ku tanimë kanë marrë edhe përgjegjësitë e caktuara.

Një përbërje e tillë, më bën mua që me plot besim e optimizëm, të deklaroj para anëtarëve të Kuvendit të komunës dhe para qytetarëve të Ferizajt, se në mandatin qeverisës katër vjeçar, do të përmbushen dhe do të tejkalohen të gjitha zotimet e dala nga platforma ime programore elektorale, për zhvillimin e mëtutjeshëm të Komunës sonë.
Më këtë kabinet, veçse ka kohë që kemi filluar me punë konkrete dhe rezultatet e para janë shumë inkurajuese. Por, në një të ardhme shumë të shpejtë, këto rezultate do të jenë edhe më të dukshme për të gjithë..
Situata momentale e komunës sonë, në shumë aspekte është mjaft sfiduese. Por, bashkë me kabinetin tim të ri, jemi duke punuar me intensitet të shtuar të punës, për të identifikuar të gjitha problemet me të cilat ballafaqohemi, njëkohësisht edhe duke ideuar dhe gjetur edhe rrugët më të mira për tejkalim të tyre.
Bashkë me drejtorët e rinj, do të jemi pjesë aktive e komunikimit me të gjithë.
Ju ftoj juve anëtarë të Kuvendit të komunës, që pa nuanca partiake, të bashkëpunoni me stafin tim, prej të cilit ju siguroj se do t'i merrni përgjigjet e duhura dhe në kohën e duhur, për të gjitha dilemat, propozimet apo shqetësimet që mund t'i keni, apo të adresuara tek ju nga qytetarët.
Po ashtu, i ftoj të gjitha grupet e interesit dhe qytetarët, që për çdo shqetësim të kërkojnë përgjigje nga stafi im, i cili për 24 orë rresht, shtatë ditë në javë, të jetë i mobilizuar në përballimin e çdo situate që mund të krijohet.
Në platformën time elektorale, jam zotuar që përveç përmbushjes së zotimeve afatshkurta dhe afatmesme në të gjitha segmentet e jetës sonë komunale, do të punoj me përkushtim për krijimin e një strategjia për ruajtjen dhe konsolidimin e vitalitetit infrastrukturor e social të Ferizajt edhe për një periudhë së paku 20 vjeçare. Kjo për shkak se Ferizaj, fuqishëm për faktorizohet si një qendër e patejkalueshme ekonomike e kulturore dhe duhet të jetë i gatshëm që me një ritëm shumë të shpejtë, të jetë në gjendje të pranojë prurje intensive në shumë fusha, të cilat, nuk do të mund të përballohen pa një strategji afatgjatë të zhvillimit.
Me stafin tim, tashmë jemi optimistë të papërmirësueshëm që do t'ia dalim me të gjitha zotimet tona. Qytetarët e Komunës sonë, në qeverisjen tonë do të ndjehen të barabartë, më optimistë, më të motivuar dhe më ambiciozë në realizimin e synimeve të tyre. Synimi ynë është-rikthimi i besimit të qytetarëve në institucionin e Komunës dhe transformimi cilësor i Komunës- në një institucion shërbimi për qytetarët tanë.
Të nderuar anëtarë të Kuvendit të komunës, të nderuar bashkëqytetarë,
Në një të ardhme të shpejtë, si kryetar komune, para jush do ta vë për njoftim dhe për shqyrtim edhe Programin tim qeverisës për periudhën 2017-2021, me të cilin, të gjithë do ta kenë më të qartë edhe me detaje se si do të jetë skema efektive e përmbushjes së zotimeve tona, për zhvillimin e komunës sonë.
Duke ju falënderuar për vëmendjen, më lejoni që edhe një herë të uroj bashkëpunëtorët e mi, drejtoret e drejtorive, për përgjegjësitë që kanë marrë!
Ju faleminderit!

Pika 6

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi – Propozim Vendimi për themelimin e komiteteve të përhershme ose obligative siç janë:

- Komiteti për Politik dhe Financa dhe
- Komiteti për Komunitete.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës e kam mbajt një takim me përfaqësuesit e partive politike të përfaqësuara në kuvend ku jemi dakorduar se në bazë ulëseve në Kuvendin e Komunës së

Ferizajt që kemi 41 anëtarë na takon t'i kemi 9 anëtarë në Komiteti për Politikë dhe Financa dhe 9 anëtar në Komitetin për Komunitete.
Në bazë të konsultimeve që kemi pasur gjatë takimit jemi dakorduar që 3 anëtarë të KPF-së të jenë nga grupi parlamentarë i PDK-së, 3 anëtarë të KPF-së të jen nga grupi parlamentarë i LDK-së, 1 anëtarë të KPF-së të jen nga grupi parlamentarë i AAK-së dhe 1 anëtarë të KPF-së të jen nga grupi parlamentarë i VV-së. Andaj kërkoj që t'i propozoni emërat nga grupet e juaja parlamentare.

z. Arian Imeri kryetar i grupit parlamentar i PDK-së - Përshëndetje Kryetar i Komunës z. Agim Ali, Nënkryetari i komunës z. Naim Fereti përshëndetje drejtor të drejtorive të komunës. E shfrytëzoj rastin të ju uroj suksese në angazhimet tuaja si ekzekutiv.

Nga PDK-së propozimet për KPF janë:
- Lumnije Morina;
- Rafiz Sejdiu dhe
- Arian Imeri.

z. Imri Hashai kryetar i grupit parlamentar i LDK-së – Faleminderit kryesuese, përshëndetje kryetar, përshëndetje nënkryetar dhe koleg të nderuar.
Kryesuese unë dua të them para se të filloj me propozimin e anëtarëve nga partia jonë për këtë komitet, se si kryesuese kemi prit shumë nga ju si kryesuesja e parë që është femër dhe po të thamë sinqerisht për herë të parë e shkele me një herë ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ku neni 39 thotë të drejtat dhe detyrat e e anëtarëve të kuvendit të komunës. pikërisht pika 1 se të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës kanë të drejtë dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësisht në punët e kuvendit. Këtë kryesuese naj mohove.

LDK dega në Ferizaj për KPF propozon:
- Imri Hashani;
- Burim Karameta dhe
- Yllka Neziri.

Perfaqesuesi i grupit parlamentarë te LVV

z. Ali Halimi Përfaqësues i grupit parlamentar i Lëvizës së Vetëvendosjes- Përshëndetje për te gjithë te pranishmit, sot unë vetëm dua te përmirësoj paraprakisht kryesuesen, ne takimin konsultativ ne nuk jemi pajtuar për mënyrën e ndarjes së vendeve në KPF, pasi ne si VV do të mendojmë dhe të gjitha dukuritë flasin që neve na takojnë dy vende në KPF.
Unë paraprakisht para se këtë çështje ta bëjnë pjesë e ligjshmërisë pasi që kjo nuk mund te kaloj kështu. Unë i kisha thirrë shefat e grupeve parlamentare që ta kemi një konsultim prej 5 minutave dhe ta diskutojmë sepse varësisht nga fuqia e vendeve të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës neve na takojnë dy vende në KPF.

Përfaqësuesi nga grupi parlamentar i AAK-së znj. Hatixhe Bungu për anëtar të KPF-së prezanton:
1. Xhavit Zariqi.

Kryesuesja e kuvendit Kristina Gashi Bytyçi - Para se të hidhemi në votime ftojë shefat e grupeve parlamentare që të kenë një pauzë prej 5 minutave për konsultimin që kërkojë anëtari i grupit parlamentar të LVV-së.

Kryesuesja e kuvendit Kristina Gashi Bytyçi - Tani jemi te propozimi i LVV-së besoj që jeni dakorduar deri më tani.

z. Ali Halimi Përfaqësues i grupit parlamentar i Lëvizës së Vetëvendosjes - Faleminderit znj.kryesuese. Pas një konsulte shihet se nuk ka një dakordimë atëherë ne si LVV nuk do të marrim pjesë në votim dhe këtë vendim të sodit ta bëjmë pjesë të interpretimit të Ligjit në Ministrinë e Pushtetit Lokal.

z. Arjan Imeri- Shef i grupit parlamentarë të PDK-së -Përshëndetje znj. Kryesuese përshëndetje për të gjithë sa i përket diskutimit në lidhje me numrin e përfaqësuesve në KPF ne jemi pajtuar në mbledhjen e përbashkët rreth këtij komiteti kjo duhet të votohet, ndërsa për kërkesat në MAPL-së do të veprojmë sipas rekomandimit tyre.
Unë kamë shikuar edhe disa vendime dhe nga kuvendet tjera komunale por edhe nga ky kuvend por asnjë herë nuk është votuar si anëtar e KPF-së Kryesuesi i Kuvendit.
Prandaj gjatë përbërjes se KPF-së nuk ka hy në llogari kryesuesi por vetëm anëtarët e tjerë,
kryesuesja ka muajt me qenë e ndonjë partie të pavarur prandaj përbërja duhet të reflekton në përbërjen e Kuvendit Komunal.

z. Amir Rexhepi nga grupi parlamentarë i AKR-së- E nderuara kryesuese të nderuar drejtor të drejtorive të nderuar anëtarë të kuvendit, dua të ju njoftoj që AKR-ja dhe NISMA kanë krijuar grupin parlamentarë 4 plus dhe ne si grup parlamentarë kemi bërë kërkesë në MAPL-së që edhe ne të përfaqësohemi në KPF, përndryshe ne do të marrim pjesë në votim dhe do të presim interpretimin ligjorë nga MAPL.

z. Xhavit Zariqi shef i grupit parlamentar i AAK-së – Përshëndetje e nderuara kryesues të nderuar drejtor të drejtorive, të nderuar dhe shumë të respektuar anëtar të Kuvendit Komunal, njëherit edhe ju uroj për detyrën e re që e keni marrë me dëshirën më të mirë që të keni shëndetë dhe të punoni për interesat e qytetit të Ferizajt.
Kjo çështje që po diskutohet tani për përbërjen e KPF-së vërtetë pak është e çuditshme se po kërkohet një diçka që nuk ka ndodhur kurrë dhe nuk mund të ndodhë, që grupet parlamentare opozitare të kenë numër më të madh të përfaqësuara ne KPF- së grupet parlamentare në pozitë. Por edhe një sqarim për grupin parlamentar 4 plus, në mandatin e kaluar ka qenë i formuar një grup 3 plus që ka pasur një kërkesë në MAPL dhe që është kthyer negativisht, sepse formimet e grupeve pas zgjedhjeve nuk njihen për ligjet e pushteti lokal.
Prandaj nuk është mirë që të merremi me vonesa është mirë që të formohet KPF-ja që në një far forme është kryesi i këtij kuvendi dhe përbërja është e precizuar saktësisht.
Kryesuesja në këtë rast nuk llogaritet me ndonjë subjekt politik por është vetëm kryesuese e votuar nga votat e kuvendit dhe nuk mund të llogaritet tani konkretisht që është e PDK-së sepse ka fituar me votat e kuvendit që ka mund të fitojë edhe një kandidat i një subjekti tjetër politik opozitarë.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi – Nëse lëvizja për vetëvendosje nuk ka propozime për KPF-në i hedh në votim propozimet e grupeve parlamentare të përfaqësuara në kuvend.
Propozimi nga grupi parlamentarë i PDK-së për KPF ishte: Lumnije Morina, Rafiz Sejdiu ,Arian Imeri, ndërsa nga grupi parlamentarë i LDK-së Imri Hashani, Burim Karameta, Yllka Neziri, dhe nga AAK –ja Xhavit Zariqi.
Pas verifikimit të prezencës së 33 anëtarëve të kuvendit që ishin prezentë për këtë propozim ishin të gjithë të pranishmit, kundër dhe abstenime nuk ka. Konstatoi se me 33 vota pro aprovohen propozimet e grupeve parlamentare.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi – E kemi edhe Komitetin për Komunitete në të cilin në bazë të numrit të ulëseve që kemi në kuvend na takojnë 4 anëtarë nga kuvendi të jenë të përfaqësuara nga grupet parlamentare ndërsa 5 duhet të jenë nga komunitetet jo shumicë jashtë kuvendit.
I kemi disa propozime nga komunitetet jo shumicë.
Presim propozimet që vinë nga grupet parlamentare dhe atë një i takon PDK-së një i takon LDK-së një i takon AAK-së dhe një VV-së.

z. Arjan Imeri shef i grupit parlamentarë i PDK-së – përshëndetje nga PDK në komitetin për komunitete propozoj znj.Mimoza Sojeva Pajazit.

z. Imri Hashani shef i grupit parlamentarë të LDK-së- Grupi parlamentarë i LDK-së propozon z.Hesat Shatrolli.

Xhavit Zariqi shef i grupit parlamentarë i AAK-së – Në Komitetin për komunitete propozon znj. Hatixhe Bungu.

z. Ali Halimi Përfaqësues i grupit parlamentar i Lëvizës së Vetëvendosjes propozohet znj.Fitore Lipovica Reshani në komitetin për komunitete.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi – Ndërsa propozimi që e kemi pasur me kërkesa zyrtare nga komuniteti jo shumicë i kemi: Nexhat Kryeziu nga komuniteti ashkalinjë, Hajriz Haziri nga komuniteti ashkalinjë, Xhemajl Jashari nga komuniteti romë, Zorica Kostiq nga komuniteti serbë dhe Zenel Elani nga komuniteti goranë.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi - e hedhë në votim propozimet anëtarët e propozuar për komitetin për komunitete.
Pas konstatimit se ishin prezentë 40 anëtarë të kuvendit për këtë propozim të gjithë ishin pro pa asnjë kundër dhe pa asnjë abstenim.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi - Konstatoi se me 40 vota pro formohet Komiteti për komunitete.

Pika 7

Propozim vendimi për caktimin e dy kandidatëve nga KK-ja për anëtarë të komisionit për ndarjen e bursave të studentëve për vitin akademik 2017-2018.
Drejtoria Komunale e Arsimit njofton se për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për student kërkohet që të caktohen 2 kandidat nga kuvendit komunal për anëtarë të komisionit për ndarjen e bursave i cili komision duhet të jetë prej 7 anëtarëve prej të cilëve 2 anëtar nga KK.

z. Arjan Imeri shef i grupit parlamentarë i PDK-së propozon Flora Avdullahu si anëtare të këtij komisioni.

z. Imri Hashai kryetar i grupit parlamentar i LDK-së, Faleminderit kryesuese, grupi parlamentar i LDK-së në komisionin për ndarjen e bursave propozon Saranda Musliu.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi – Verifikohet prezenca e anëtarëve të kuvendit, prezent janë 39 anëtarë dhe e hedhë në votim propozimet për këtë komision ku pro ishin 39 anëtar dhe nuk kishte asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Me 39 vota pro konstatoj se miratohet propozimi i vendimit të komisionit për caktimin e 2 anëtarëve të komisionit për bursa.

Pika -8

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi – Propozimi për miratimin e vendimit për emërimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve në ndërmarrje publike
KRM „Pastërtia„ SHA
KRUK „Bifurkacioni„ SHA
NP Stacioni i Autobusëve
NP „Ambienti„

Kërkojë që të propozohen emrat për anëtar e këtyre komisioneve nga grupet parlamentare.

z. Xhavit Zariqi shef i grupit parlamentar i AAK-së Faleminderit kryesuese nga grupi parlamentar i AAK-së propozojmë që ne KRM „Pastërtia„ SHA në komisionin e aksionarëve Agnesa Haradini, në KRUK „Bifurkacioni„ SHA Shemsi Sojeva në NP „Stacionin e "Autobusëve„ Kamer Kameri dhe në NP „Ambienti„ Përparim Qalaj.

z. Arjan Imeri shef i grupit parlamentarë i PDK-së për ndërmarrjen publike „Stacioni i Autobusëve„ propozoj Makfire Musa. NP „Ambienti„ Fatmir Ademi, në KRUK „Bifurkacioni„ SHA Gëzim Haxhimusa dhe në KRM „Pastërtia„ SHA Kushtrim Llabjani.

z. Imri Hashani nga grupi parlamentar i LDK-së – për Komisionin komunal te aksionareve ne KRM „Pastërtia„ propozoj: Jahir Sokolin, ne KRUK „Bifurkacioni„ Fadil Lipovica, N.P „Stacioni i Autobusëve„ Përparim Guta, N.P „Ambienti„ Ramadan Baliu.

z. Ali Halimi Përfaqësues i grupit parlamentar i Lëvizës së Vetëvendosjes – Ne si Lëvizje e Vetëvendosje kemi vetëm një propozim dhe atë NP propozoj Xhevat Sallahun.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi - Anëtar te kuvendit kemi disa propozime nga grupet parlamentare po i hedhim veç e veç ne votim ne bazë të radhës së propozimeve që na erdhën nga grupet parlamentare.
Propozimi i parë ka ardhur nga grupi parlamentar i AAK-së me këto propozime:
për KRM „Pastërtia„ SHA është Agnesa Hajredini,
KRUK „Bifurkacioni„ SHA Shemsi Sojeva
NP „Stacioni i Autobusëve, Perparim Qalaj
NP „Ambienti„Kamber Kameri
Para se të hedhet ne votim konstatoj se në sallë janë prezent 22 anëtar të kuvendit
Pro janë 22 anëtarë, nuk ka abstenime as kundër andaj konstatohet se me 22 vota pro kalon propozimi nga grupi parlamentar i AAK-së

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi – I kemi propozimet nga grupi parlamentar i PDK-së dhe atë:
NP „Stacioni i Autobusëve„ e kemi Makfire Musa
NP „Ambienti„ Fatmir Ademi
KRM „Pastërtia„ SH.A Kushtrim Llabjanin
KRM Bifurkacioni SH.A Gzim Haxhimusa.
Para se të hedhet ne votim konstatoj se në sallë janë prezent 22 anëtar të kuvendit
Pro janë 22 anëtarë, nuk ka abstenime as kundër andaj konstatohet se me 22 vota pro kalon propozimi nga grupi parlamentar i PDK-së

Kemi propozimet nga grupi parlamentar i VV-së ku është propozuar Xhevat Sallahu ne ndërmarrjen publike NP „Stacioni i Autobusëve„.
Hedhet në votim ky propozim:
Prezent janë 40 anëtarë të kuvendit prej të cilëve 19 pro dhe 21 kundër pa as një abstenim.
Konstatohet se me 21 vota kundër nuk kalon ky propozim.

z. Xhavit Zariqi shef i grupit parlamentar i AAK-së – një sqarim të vogël – për çështje të mbyllur nuk ka nevojë të votohet për herë të dytë andaj konsideroj që nuk ka nevojë te votohet për propozime tjera pasi që propozimet me lartë u aprovuan.
Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi – pasi që propozimet nga grupi parlamentar i LDK-së ekziston po e qesim ne vota. E kemi Jahir Sokolin për komisionin e aksionarëve në KRM„Pastërtia„ , Fadil Lipovica per komisionin e aksionareve KRU „Bifurkacioni„ Përparim Guta për NP „Stacioni i Autobusëve„ dhe Ramdan Baliun NP „Ambienti„.
Konstatohet se janë prezent 30 anëtarë të kuvendit prej të cilëve 12 janë pro ndërsa kundër janë 22 dhe abstenime nuk ka.
Konstatoj se me 22 vota kundër nuk kalon propozimi nga grupi parlamentar i LDK-së.

Pika 9

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi – Propozim vendimi për fillimin e procedurave për Rishikimin e PZHK-së.

z. Lulzim Aliu , Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit– Realisht propozimin e kemi parë të gjithë dhe në atë propozim e kamë dhënë një sqarim të shkurtër pse është e domosdoshme me e ba një trajtim qe unë e kam quajtur Rishikim te planit zhvillimor. Por fillimisht po dua me u përgjigje ne disa çështje që ngriti z.Svarqa ne kuptimin e preambulës gjegjësisht edhe neneve e ligjeve në të cilat jam bazua.
Është reale që e kemi përdorur ligjin e planifikimit hapësinorë që është në fuqi për me iu tregu se edhe hartimi edhe revidimi edhe shqyrtimi edhe monitorimi është kompetencë e komunës-kompetencë e Drejtorisë së Urbanizmit.
E kamë përdorur edhe udhëzimin administrativ 11/2015 sepse sipas këtij udhëzimi është normale në kuadër të monitorimit sepse unë jam përgjegjës për planin zhvillimor si drejtor i Urbanizmit.
Dhe gjatë monitorimit te PZHK-së kamë hasur në probleme te pa kapërcyeshme të cilat na duhet me i trajtuar dhe me i rishikuar.
Pretendimi im kryesor ka qenë që ju me qenë të bindur që shqyrtimi i këtij dokumenti nuk është duke u bërë me inate me tendenca me paramendim për anulimin e diçkait e për me e fut diçka të re.
E kam provuar dhe po ju them prap sot se unë nuk bi pre as për interesat individuale dhe as familjare që po pretendon ish-kryetari e as grupeve te interesave te caktuara në qoftëse nuk e kam interesin publik.
Është e vërtetë se vendi për te cilin janë planifikuar varrezat e qytetit ka qenë i ekonomisë pyjore dhe me një vendim është kthyer nga Qeveria për shkak te interesave te komunës por është edhe fakt tjetër se Ministria e FSK-së është Qeveri dhe ne kemi kërkesa nga FSK-ja qe i kemi pasur edhe më herët ne vitin 2017 me shkrim pse ajo hapësire nuk është e përshtatshme për varreza.
Arsyetimin do ta bëjë me vone përmes projektorit.
Plani zhvillimore ka qenë dashur te behet ne vija te trasha. Janë bere disa gabime te cilat ne po i shohim ne teren.
Mund të quhet rishikim, apo anulim apo shtyrje te zbatimit te ndonjë aktivitetit te Planit te veprimit të PZHK-se. Ajo çka është e rëndësishme për me u thanë është kërkoj zgjedhje e zgjedhje është përmirësimi.
Është kompetenca e jona qysh me përmirësuar sepse si i tillë nuk mundet me u zbatuar.

Sot kërkoj ndihmën e juaj ne kuptim te votimit pikërisht në këtë fushë.

z.Nehat Mustafa –nga grupi parlamentar i PDK-së – Faleminderit kryesuese, unë nuk dua te hy ne detaje te planit zhvillimore pasi që nga te dy anët kane qenë përfaqësues te pushtetit qoftë pjese e asamblesë komunale dhe me siguri qe i dine rrjedhat si ka ardhur deri te miratimi i një plani të tillë.
E di që njëri prej këshilltareve qe sot është asamblist, Enver Haliti e kamë dëgjuar duke thënë ai publikisht që ky plan zhvillimore është derivat i një peticioni te falsifikuar dhe nëse mundet tash Drejtori i urbanizmit me naj hekë këtë dilemë a është ky plan i miratuar si një derivat i një peticioni të falsifikuar apo nuk është. Nëse është derivat i një peticioni te falsifikuar unë mendoj qe duhet me menduar që a mund të rishikohet .Unë mendoj që duhet te anulohet komplet, sepse nëse jo sot do te detyrohemi pas një kohe tjetër qe ta marrim një vendim te tillë sepse e dimë që po flitet se disa procedura i ka filluar prokuroria.

z. Imri Hashani nga grupi parlamentar i LDK-së – Faleminderit kryesuese sot ne para vetit e kemi një pikë shumë të rëndësishme e kemi planin zhvillimor komunal. Të gjithë e dimë se plani zhvillimor komunal s'ka 4-5muaj që është aprovuar e sot po flitet me shfuqizuar. Unë mendoj që kjo pikë e rendit të ditës nuk ka qenë mirë fare të jetë në rendin e ditës po u votua si u votua pa u dhënë mendimi i delegatëve.
Këtë e them për dy arsye: një se ligji nuk thotë askund se Plani zhvillimore komunal mundet me u rishikuar dhe e dyta Plani zhvillimor komunal dhe buxheti komunal janë dy nga dokumentet e rëndësishme që i miraton Kuvendi komunal e te bisedohet për ndërrim apo anulim si po thuhet me u anuluar pa u kaluar nëpër komitetin për Politik dhe Financa ku ligji thotë se çdo dokument duhet me u kaluar përmes Komitetit për Politik dhe Financa dhe me ardhë në kuvend.
Unë nuk e di çka është kaq e ngutshme kur ende nuk ka filluar të zbatohet.

z. Enver Haliti, përfaqësues o grupit parlamentar i Lëvizjes së Vetëvendosjes– Faleminderit kryesuese shfrytëzoj rastin të ju uroj edhe njëherë punë të mbarë juve dhe qeverisë komunale gjithashtu edhe dy anëtarëve te kuvendit që sot e dhanë betimin, ju dëshiroj punë të mbarë.
Para vetës kemi një pikë të rendit të ditës rreth Planit zhvillimor komunal besoj që ne këtë kuvend por edhe në debatet e ndryshme është debatuar shumë.
Kjo temë ndoshta ka qenë njëra ndër temat më të debatuara edhe nga asambleja e kaluar. Arsyetimet qe i ka dhënë Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit besoj kanë mundur më qenë pak, që ka mundur me u pa shkeljet për mënyrën se si është hartuar.
Gjatë gjithë kohës e kam cekur disa herë edhe sot po e them se degradimi i qytetit do te thotë ka filluar që nga viti 2014. Qysh aso kohe ish-drejtor i urbanizmit ka filluar revidimi i dy zonave urbane të qytetit 1 dhe 8 ne kundërshtim me ligjin për planifikim hapësinor çka është vërtetuar nga ministria dhe inspektorati republikan.
Kur jam lodhur e nuk kam pasur më fuqi të vazhdoj tutje jam munduar të vej një jorgan gjithë asaj katrahure urbane që ka ndodhur ne Ferizaj.
Drafti i parë më është ofruar me 702 apo 703 faqe dhe më është ofruar 2 dite para mbajtjes se mbajtjes se mbledhjes se asamblesë komunale për aprovim. Dhe atëherë kam thënë pse po shkelet ligji dhe po e shoh se qenka shkelur ligji me dy këmbë.
Sot kanë dalur vetëm disa probleme, drejtori që i ceku. Unë them se mijëra probleme kanë me i pa qytetarët nesër me realizimin e të drejtave të tyre pronësore.
Nuk mundemi me lënë çka do letë bëhet, ky kuvend ia ka dhënë vizën këtij Plani zhvillimor, kuvendi nëse është nevoja edhe njëherë të anuloj krejt, të filloj prej fillimit dhe të eliminohen të gjitha ato parregullsi qe kanë ndodhur. Të hartohet një planë i mirëfilltë nga ekspertët.
Është dashtë të merret për bazë Plani zhvillimor i kaluar dhe çdo ndryshim i tij të arsyetohet mjaft mirë që të bindet asambleja komunale më votuar at ndryshim.

z. Muharrem Svarqa antarë i grupit parlamentat i LDK-së- Të nderuar koleg, nuk dola këtu as për tu fjalosur sa për të vlerësuar se a kemi bërë falsifikim e sepse nuk është kompetencë e jonë. Ky kuvend nuk është as Gjykatë as Prokurori. Sa më takon mua unë nuk pajtohem me atë mënyrë që tash diskutohet sikur ne duhet të jemi të gjithë transparent sepse këtu po diskutojmë për një dokument i cili është i aprovuar dhe ne po e kontestojmë këtë dokument që pa të drejt është dhanë për diskutim sepse asnjë ligj nuk e parasheh rishikimin si mundësi. Ligjet e caktojnë afatin e një dokumenti të miratuar. Mund të themi se në hartat zonale nuk mund të aprovohen në këtë kuvend pa respektimin e procedurave paraprake, sepse kërkohet që të bëhet një debat publik nga të gjitha komunitetet dhe ato e specifikojnë se cili do të jetë koeficient, etazhiteti por që duhet të jetë edhe në harmoni me ligjet.
Edhe spitalin ku të doni çone,por unë mendoj që për spitalin janë realizuar të gjitha procedurat e prokurimit, është bërë studimi i fizibilitetit dhe stadimet gjeomekanike të tokës, te parku i lirisë, ku janë 8,5 hekar të cilat janë të destinuara për spitalin dhe objektet shëndetësore. Unë mendoj që atje ka mundësi që të ndërtohen komplekse të objekteve shëndetësore për të ardhmen.
Qeveria e Kosovës e ka nxjerrë një vendim për varreza në të cilin ka marrë pjesë edhe Ministri i FSK-së dhe i cili vendim është publikuar në gazetën zyrtare nr.8 me datën 24.03.2017. Obligimi i kuvendit dhe i Kryetarit të komunës është që t'i zbatojnë vendimet e nivelit qëndror.

z. Lulzim Aliu, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis- Të nderuar deputet dhe anëtar të kuvendit unë e kam formuar një komision profesional të fushave të ndryshme dhe nuk jam tu vendosur vet, nuk dua me marr përgjegjësin për të ardhmen e Ferizaj. Unë jam tu dasht me punë, unë me këto plane nuk mundem me punuar. Vendimi i Kuvendit i ka anuluar të gjitha vendimet në të gjitha zonat që kanë të bëjnë me planin Hapësinor që kanë qen më herët.
Sa i përket parcelës së varrezave FSK-ja ka bërë kërkesë me shkrim që mos të bëhen varrezat aty se mund të rrezikohen qytetet gjatë ceremonive të varrimit nga ushtrimet e FSK-së.
Natyrisht që Plani zhvillimor në kushte normomale nuk duhet me u reviduar, jo për 4 muaj por as për 5 vite se kjo është strategji por ju nuk keni bërë strategji z. Hashani.

z. Xhevat Sallahui, përfaqësues o grupit parlamentar i Lëvizjes së Vetëvendosjes- Faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë, nuk po hy ne detale të ligjit që u diskutua por nëse i shikojmë sot faktet në qytet shohim se nuk ka kontroll në ndërtim, është bërë katrahurë qyteti, Ndërtimet janë pa plan afër njena tjetrës s'kanë mundësi me hy zjarrfikësit në rast të ndonjë zjarri, Ndërtesat shkallë emergjente nuk kanë dhe e kemi një degradim të qytetit. Prishen ndërtesat e vjetra pa kontroll.

z. **Xhavit Zariqi shef i grupit parlamentar i AAK**-së- Faleminderit Kryesuese, Pika e rendit të ditës që është duke u diskutuar është një çështje që duhet të na brengos të gjithë neve dhe qytetarët e Komunës së Ferizajt. Sepse po flitet për një diçka që akoma pa u filluar të realizohet, e të realizohet kërkohet ndryshimi ose revidimi. Nëse fillojmë edhe një herë me rishikuar dhe përmirësuar PZHK ne na shkojnë edhe nja dy vite si na ka marrë plani aktual. Planin zhvillimor komunal, e ka obligim ligjor ta hartoi çdo komunë dhe nuk mund të jetë nën ndikimin e disa nënshkrimeve të falsifikuara apo të pa falsifikuara. Për këtë çështje vendos gjykata. Nuk mund të pajtohem me ju, se ju keni filluar procedurat ligjore për hartimin PZHK-së. Sepse janë përfill pikë për pikë, me debate nëpër fshatra dhe lagjet e qytetit për miratimin e tij. Sa i përket çështja e spitalit është fai i z. Svarqës, psc sc ka filluar të paktën ndërtimin e spitalit.
Te çështja e varrezave unë nuk mendoj se është pengesë për FSK-në si dhe nuk është pengesë e qytetarëve të fshatit Balaj.
Ndryshimin e PZHK-së është i pa pranueshëm dhe jashtëligjshëm. Unë mendoj që të specifikohet nga ana e Drejtorit të Urbanizmit se çka duhet të ndryshohet e jo të fillohet me procedurat e revidimit PZHK-së.
Unë nuk mund të pranoj se me këtë plan janë cenuar interesat e qytetarëve.

z. Muharrem Svarqa antarë i grupit parlamentat i LDK-së- Falënderoj z. Zariqin që është eksplicit që është nga pozita e pushtetit sepse ne kemi qen pjesë e pushtetit sepse ne kemi pjesë e përbashkët e marrjes së vendimeve. Këtë vendim e ka marrë ky kuvend e jo z Svarqa. Lidhur me spitalin ka qenë kërkesë e komunitetit shëndetësorë dhe nuk ka asgjë të keqe. Nuk kam kundër dislokimit të spitalit por problemi është PZHK. Ne nuk kemi marrë vendime të pa koordinuara nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

z. Arjan Imeri shef i grupit parlamentarë i PDK-së- Përshëndetje për të gjithë, besoj se të gjithë pajtohemi se PZHK është një dokument i rëndësishëm për zhvillimin e komunës tonë. Nga materialet na janë dërguar në këtë seancë del që ky dokument është me gabime teknike, andaj mendoj që vetëm ky organ mundë të bëjë përmirësimet e nevojshme. Në bazë të vërejtjeve që i dha drejtori ne si kuvend duhet ti japim një zgjedhje këtij problemi. Momentalisht ne e kemi Problemin e varrezave. Unë shfrytëzoj rastin ta përgëzoj Drejtorin e urbanizmit për formimin këshillit konsultativ të profesionalistëve në fushën e urbanizmit. Besoj se me krijimin e kësaj trupe i është dhënë një mundësi një rishikimi nga analizat e bëra. Andaj mendoj që dokument duhet të rishikohet me profesionalizëm se është në interes të qytetit dhe qytetarëve të Ferizajt.

z. **Nehat Musta përfaqësues i grupit parlamentar i PDK-së-** Po e them publikisht se unë do ta përkrahi çdo propozim që vjen nga qeveria lokale kur të bindem se ato propozime janë në interes të qytetarëve dhe asnjë herë nuk do të jem pjesë e votimeve të cilat do të shkojnë të individëve.

z. Muharrem Svarqa anëtarë i grupit parlamentar i LDK-së- Është në dobi të shtetit dhe në dobi të institucionit si që është komuna që të jetë thithëse në të gjitha degët e ekonomisë. Prandaj edhe ndërtimtarinë unë konsideroj me shumë interes.

z. Balton Dërguti anëtarë i grupit parlamentar i LDK-së- Përshëndetje fillimisht i uroj suksese qeverisë aktuale, kryesueses të gjithë kolegëve gjatë këtij mandati. Mendoj se nuk është mirë me u përdorë gjuha fyese kur është rasti të z. Haliti. Lidhur me ankesën e Komandantit të FSK-së për çështjen e varrezave është qudi që me një takim së bashku me Kryetarin Svarqa asnjë ankesë nuk ka qenë në këtë drejtim. Vetëm ka qenë çështja e rregullimit të rrugës së varrezave, ku jemi marrë veshë ka nuk i pengon FSK-së.

z. Lulzim Aliu, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis- Në mënyrë elektronike përmes projektuesit po ua prezentë vendimin e kuvendit komunal dhe disa hartave në mënyrë që mirë të niheni për ndërmarrjen e këtij hapi.

z. Shkelzen Selmani anëtarë i grupit parlamentar i LDK-së - Faleminderit kryesuese, përshëndetje kryesuese, koleg dhe kolege. Unë prita sot prej drejtorit që ka me qenë këtu prezent ai Këshilli konsultativ profesional. Në dokumentet që me kanë ardhur janë vetëm dy pika të cilat kërkohet për me i ndryshuar, varrezat dhe qerdhët, e tash këtu dulën shumë, si shëndetësia, parkingjet, parcelat me shumë destilime, objektet arsimore etj. Drejtor precizoje çka ke me ndryshuar, arsyetoje dhe unë ka me përkrahë e jo kështu. Për çdo ndryshim merre pëlqimin nga ministrit përkatëse.

z. Gëzim Kokollari anëtarë i grupit parlamentar i LDK-së - Përshëndet kryesuese, përshëndetje për të gjithë kolegët. Besoj që mirë është të merret paraprakisht një rekomandim ose një leje nga ministria përkatëse se a kemi drejt me i proceduar këto çështje.

z. Ali Halimi Përfaqësues i grupit parlamentar i Lëvizës së Vetëvendosjes- Ne jemi në dilemë a të kërkojmë një plan tjetër zhvillimor apo të presim përgjigjeje për falsifikime.

z. Burim Karameta anëtarë i grupit parlamentar i LDK-së - Përshëndetje kryesuese, përshëndetje për të gjithë kolegët. Unë mendoj se gabimet ndodhën qysh nga fillimin i kësaj seance në mungesë të debatit për mos dhënien e fjalës të gjithëve që e kërkuan. Po orientohem në pikën që është më e rëndësishme, te Plani zhvillimor që është i rëndësishëm pas Statutit të komunës. Kërkesa ime është që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër. Dhe kjo pikë paraprakisht të kaloj nëpërmes Komitetit për Politikë dhe Financa.

z. Xhavit Zariqi shef i grupit parlamentar i AAK-së- Si kryetar i aleancës jam kundër propozimit të ndryshimit të Planit Zhvillimor të Komunës dhe jam që ne të marrim vendim që të përmirësohet ridestinimi i pronave publike dhe atyre private që janë me interes publik.

z. Lulzim Aliu, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis- Unë edhe një herë po dua me reflektu se jam brenda se jam brenda ligjit dhe unë propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shndërrohet në dy qëllime.
- Vendimin ta Marrim për rishikim të destimeve të pronave pulike dhe pronave private janë të destinuara për qëllime publiken PZHK të miratuar me datën 21.09.2017.
- Përmirësimin e gabimeve teknike në pjesën tekstuale dhe hartografike dhe digjitale me qëllim të harmonizimit të tyre.
E hedhë në votim, prezent janë 29 anëtarë të kuvendit dhe pro propozimit të Drejtorit të urbanizmit janë të gjithë të pranishmit, nuk ka kundër dhe nuk ka abstenim, andaj konstatoj se me 29 vota pro pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim, aprovohet propozimi nga drejtori i urbanizmit.

Pika 10

Caktimi i orarit të mbledhjeve të KK së Ferizajt për vitin 2018.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi.- A ka dikush vërejtje rreth këtij orari, dhe pasi nuk ka vërejtje e hedhe në votim, prezent janë 28 anëtarë të kuvendit dhe pro propozimit janë të gjithë të pranishmit, nuk ka kundër dhe nuk ka abstenim dhe u konstatua se me 28 vota pro, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim aprovohet orari të mbledhjeve të KK së Ferizajt për vitin 2018.

Pika 11

Propozim – Vendim për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit nga radhët e partive politike të përfaqësuara në Kuvend, për hartimin e Planit të kuvendit të KK-së.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi.- Kërkoj nga secili grup parlamentar të propozoj nga një përfaqësues të këtij komisioni. Komisioni do të bëjë një plan vjetor të punës i cili e përmban numrin e mbledhjeve, kohën e mbajtjes së mbledhjeve, dhe temat që do të shqyrtohen.
Përfaqësuesi i grupit parlamentarë i PDK-së - propozoj Arben Imerin;
Përfaqësuesi i grupit parlamentarë i AAK-së - propozoj Zymrije Haxhimusës;
Përfaqësuesi i grupit parlamentarë i LVV-së - propozoj Dritëro Hysenin;
Përfaqësuesi i grupit parlamentarë të NISMA - propozoj Florije Musën;
Përfaqësuesi i grupit parlamentarë i Aleancës - propozoi Amir Rexhepin;
Përfaqësuesi i grupit parlamentarë i LDK-së - Propozoi Gëzim Kokollarin.

Kryesuesja e kuvendit znj. Kristina Gashi Bytyçi.- Prezent janë 30 anëtarë të kuvendit dhe pro propozimit janë të gjithë të pranishmit, nuk ka kundër dhe nuk ka abstenim dhe u konstatua se

me 30 vota pro, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim. Aprovohet vendimi për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit nga radhët e partive politike të përfaqësuara në kuvend, për hartimin e planit të kuvendit të KK-së.

Pika 12

Pyetje dhe kërkesa të anëtarëve të KK-së.

1. **z. Nehat Mustafa përfaqësues i grupit parlamentarë i PDK-së –** E nderuara kryesuese, drejtor komunal dhe kolegë. Kërkoj nga i Kryetari i komunës që për mbledhjen e ardhshme të përgatit një Raport të detajuar të gjendjes të cilën ai e ka gjetur Komunën e Ferizajt.
2. **Për Drejtorin e Arsimit,** të kemi një Raport të gjendjes në të cilën është arsimi i Komunës së Ferizajt.
3. **Për Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,** të sjellë një Raport të detajuar të gjendjes në këtë Drejtori.

Pika 13

Nuk kishte diskutime rreth kësaj pike.

Mbledhja përfundoi në ora 14,40 h.

Procesmbajtësi

Isuf Salihi

Kryesuesja e KK-së

Kristina Gashi Bytyçi